

Bio

Tartar Bazaj, është Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i zgjedhur me Vendimin Nr.19,datë 08.02.2018,nga Kuvendi i Shqipërisë nga radhët e avokatisë.

Ai mban funksionin e Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Prokurorëve dhe Anëtar i Komisionit të Disiplinës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Diplomuar për Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë. Përvoja e tij e punës përfshin detyra dhe emëime të ndryshme ndër vite. Në 31 Mars 1995 me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë deri në vitin 2000. 03 Janar 2001 - 05 Shkurt 2018 ka ushtruar profesionin e avokatit ku ka themeluar dhe drejtuar Studion Ligjore “BAZAJ” Sarandë – Tiranë.

Përgjatë viteve 2008-2012 ka qenë Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatëve të Shqipërisë. Në vitin 2012 ka botuar librin monografik dedikuar krahinës së tij “Shkoza dhe Baba Arshi Bazaj”.

Ka qënë pjesëmarrës aktiv por edhe sponsor në organizime të ndryshme me karakter kulturor, humanitar dhe atdhetar si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ka qënë disa herë i ftuar nga Diaspora Shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku ka dhënë edhe intervista televizive lidhur me drejtësinë dhe historinë e krahinës së Labërisë.

Lektor i jashtëm në Kriminologji, Kriminologji-Penologji dhe Elementët e Kriminologjisë Klinike prej vitit 2019 dhe në vazhdim.

Mandati i tij në detyrën e Anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është një mandat me afat pesë vjeçar, i vlefshëm nga Dhjetori 2018 deri në Dhjetor 2023.